



RAPORT VJETOR 2025

www.asf.al

TABELA E PËRMBAJTJES

STRUKTURA DREJTUESE E ASF	4
ANËTARËT E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË ASF	5
ORGANOGRAMA E SHOQËRISË ASF:	7
HISTORIKU INSTITUCIONAL	8
RRJETI I DEGËVE TË AGRO SOCIAL FUND	8
MISIONI & VLERAT THELBËSORE	9
SFIDAT & ARRITJET 2025	10
QËLLIME STRATEGJIKE PËR VITIN 2026	12
ARRITJET NË KREDIDHËNIE	13
PRODUKTET E KREDISË	16
SEKTORËT E INDUSTRISË	17
MENAXHIMI I PORTOFOLIT NË RISK	18
MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	21
AKTIVITETE	24
IT	25
PERFORMANCA SOCIALE	26
RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR	27
BILANCI	29
PASQYRA E TË ARDHURAVE	29
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARAS	29
BASHKËPUNËTORËT TANË	30



MESAZHI NGA DREJTUESJA EKZEKUTIVE

Të nderuar klientë, partnerë, punonjës dhe bashkëpunëtorë, Viti 2025 ishte një vit i rëndësishëm për Agro Social Fund, një vit që na sfidoi të jemi më pranë klientëve tanë, më të qëndrueshëm në vendimmarrje dhe më të përkushtuar ndaj misionit tonë për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe social të komuniteteve ku operojmë. Në një mjedis ekonomik që vijon të karakterizohet nga sfida dhe pasiguri, ne vazhduam të qëndrojmë pranë individëve, familjeve dhe sipërmarrjeve, duke ofruar financim, mbështetje dhe besim për ata që kërkojnë të zhvillojnë aktivitetin e tyre apo të përmirësojnë cilësinë e jetës. Gjatë vitit 2025, ASF u shërbeu 2,386 klientëve përmes disbursimit të rreth 951 milionë lekëve, ndërsa portofoli i kredisë aktive arriti në rreth 1.4 miliardë lekë, në shërbim të 3,690 klientëve. Këta tregues përfaqësojnë jo vetëm rritjen e aktivitetit tonë, por mbi të gjitha besimin që klientët vazhdojnë të kenë tek institucioni ynë. Ndikimi ynë matet përtej shifrave financiare. Përmes punës sonë kemi kontribuar në përmirësimin e mirëqenies së mijëra familjeve, duke ndikuar pozitivisht në jetën e 6,768 fëmijëve, duke mbështetur 118 klientë nga grupet e marginalizuara dhe duke krijuar mundësi për sipërmarrës të rinj që zgjedhën të ndërtojnë të ardhmen e tyre me mbështetjen e ASF. Besnikë ndaj misionit tonë, kemi vijuar të mbështesim zhvillimin e ekonomisë rurale, e cila mbetet një nga shtyllat kryesore të aktivitetit tonë. Në fund të vitit, 54% e klientëve tanë ishin të lidhur me aktivitete që zhvillohen në zonat rurale, duke reflektuar angazhimin tonë për të qenë një partner i qëndrueshëm për fermerët dhe bizneset rurale. Njëkohësisht, kemi vijuar të promovojmë përfshirjen financiare të grave, të cilat përbëjnë rreth 41% të bazës sonë të klientëve. angazhimin tonë për të qenë një partner i qëndrueshëm për fermerët dhe bizneset rurale. Njëkohësisht, kemi vijuar të promovojmë përfshirjen financiare të grave, të cilat përbëjnë rreth 41% të bazës sonë të klientëve.

Viti 2025 shënoi gjithashtu hapa të rëndësishëm në forcimin institucional të ASF. Konsolidimi i degës së Shkodrës, investimet në teknologji dhe sigurinë kibernetike, si dhe zgjerimi i bashkëpunimit me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë, krijuan baza më të forta për rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të institucionit në vitet që vijnë. Asnjë nga këto arritje nuk do të ishte e mundur pa besimin e klientëve tanë, mbështetjen e partnerëve financiarë, orientimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm të stafit të ASF. Secili prej jush ka kontribuar në ndërtimin e një institucioni më të fortë, më profesional dhe më të aftë për t'iu përgjigjur nevojave të komuniteteve që shërbejmë. Teksa shohim drejt vitit 2026, mbetemi të udhëhequr nga i njëjti vizion: të krijojmë mundësi, të mbështesim zhvillimin dhe të ndërtojmë marrëdhënie afatgjata të bazuara në besim, integritet dhe përgjegjësi.

Ju falënderoj për besimin dhe bashkëpunimin tuaj të vazhdueshëm
Na priftë e mbara!

Rozana Orozi
Drejtore Ekzekutive



STRUKTURA DREJTUESE E ASF

Më datë 28.07.2025 u finalizua transformimi i formës ligjorë të shoqërisë nga Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK) në Shoqëria Aksionare (SHA), konform kërkesës së nenit 32 pika 5, të Rregullores “Për Licencimin, Ushtrimin e Veprimtarisë, Revokimin e Licencës dhe Likuidimin e Portofolit të Kredive të Krijuar nga Ushtrimi i Veprimtarisë Financiare nga Subjektet Financiare Jobanka”, miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 42, datë 07.08.2024, si dhe mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 ” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Me këtë ndryshim, shoqëria ka zgjedhur modelin e qeverisjes me dy nivele, i cili përbëhet nga:

- Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit të Vetëm si organi më i lartë drejtues;
- Këshilli Mbikëqyrës, si organ mbikëqyrës.

Drejtimi ekzekutiv i institucionit ushtrohet nga Drejtori Ekzekutiv, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Statutin e shoqërisë.

Mënyra e funksionimit dhe kompetencat që ata kanë janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 të Shoqërive Tregtare, si dhe në statutin e shoqërisë “ASF” SHA.

“ASF” SHA ruan të njëtin organizim struktural me 5 departamente:

- Departamenti i Kredisë,
- Departamenti i Financës,
- Departamenti i Menaxhimit të Riskut,
- Departamenti i Burimeve Njerëzore & Shërbimeve, Juridikut dhe Marketingut,
- Departamenti i Teknologjisë së Informacionit.

Gjithashtu , në strukturën e ASF-së bën pjesë dhe Sektori i Auditit të Brendshëm, i cili është nën varësi të Drejtorit Ekzekutiv dhe objekt kontrolli nga Komiteti i Auditit, i miratuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës me Nr. 13 dt. 29.09.2025.

Të gjithë drejtuesit e departamenteve varen nga Drejtori Ekzekutiv (secili prej tyre ka një përkrahje pune specifike) dhe kanë në strukturë specialistë të departamentit që ndihmojnë në mirëadministrimin e proceseve të punës.

Në nivel menaxhimi në degë, struktura është si më poshtë: Drejtor Dege, Përgjegjës Dege (sipas vlerësimit), Asistente Dege, oficerë kredie dhe staf ndihmës.

ANËTARËT E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË ASF



Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

Prof. Asoc. Dr. Altin Muça është diplomuar pranë Fakultetit të Ekonomisë në vitin 1992. Deri në vitin 2003 ka punuar si Profesor në Departamentin e Marketingut dhe Turizmit të Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës. Në vitin 2003 ai iu bashkua Fondit Besa në pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Marketingut. Ai ka disa kualifikime nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe nga Agjensia e Bashkëpunimit Ndërkombëtar Japonez. Ka marrë pjesë në disa seminare me temë “Financimi i Tregtisë Ndërkombëtare dhe Marketingu Ndërkombëtar” për të cilat është certifikuar. Në Shtator të vitit 2003 ai mori titullin Doktor i shkencave dhe në Korrik të vitit 2011 mori titullin Profesor i Asociuar.



Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës

Znj. Luiza Shehu me një eksperiencë të gjatë në sektorin Ligjor, është diplomuar në Fakultetin Juridik në vitin 1995. Ka mbajtur pozicionin e Drejtorit në Departamentin Ligjor të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit. Në vitin 2004 mori një diplomë masteri për Administrim Publik në Universitetin e Nebraskës. Ajo iu bashkua sektorit të mikrofinancës në vitin 2007, në pozicionin e Drejtorit Ligjor, Burimet Njerëzore & Departamentit të Administrimit të Brendshëm në FAF. JSC (ish MAFF). Që në vitin 2016 mban postin e Drejtorit të Departamentit Ligjor të Fondit Besa. Disa përvoja të tjera pune përfshijnë: Pedagoge e Ligjit Bankar dhe Sigurimeve, Eksperte legale e GTZ, Avokate e liçensuar që në vitin 2013.



Përparim Xhafa – Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës

Z. Përparim Xhafa është diplomuar në “Institutin Bujqësor” në degën Ekonomi në vitin 1990. Karriera e tij në sektorin bankar filloi në vitin 1994 si Specialist Kredie pranë bankës “BKT”. Në vitin 1998 ai mbajti pozicionin e Drejtorit të Degës së Thesarit në Ministrinë e Financave dhe në vitin 2004 iu bashkua Sektorit të Auditimit të Brendshëm në të njëjtën ministri. Karriera e tij përfshin gjithashtu pozicionin e Drejtorit të Fakultetit në “Universitetin Europian të Tiranës”, Drejtor i Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, si dhe aktualisht Drejtor në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në “Radio Televizionin Shqiptar”. Ai ka marrë pjesë në disa seminare lidhur me auditimin e brendshëm dhe në vitin 2023 është certifikuar si Vlerësues Teknik për standardin ISO/IEC 17021:2015




Bajram Korsita – Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës

Z. Bajram Korsita është diplomuar në Universitetin e Tiranës në degën Ekonomi Industriale në vitin 1987. Në vitin 1993 ai mbajti pozicionin e Oficerit të Kredive pranë “Bankës Kombëtare Agrare”. Karriera e tij e gjatë përfshin rolin e Oficerit Rajonal të Kredive pranë “Fondit Besa”, Drejtor Ekzekutiv për shumë vite në Kompaninë e Parë të Zhvillimit Financiar, si edhe Drejtor Ekzekutiv në Fondacionin Shqiptar të Garancisë për Zhvillim. Bajram Korsita ka ushtruar për një periudhë të gjatë profesionin e pedagogut dhe aktualisht është pedagog në Universitetin “Aleksandër Moisiu”.




Besnik Bani – Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës

Z. Besnik Bani është diplomuar në Universitetin e Tiranës në degën Ekonomi në vitin 1986. Karriera e tij në sektorin bankar filloi në vitin 1992 si Specialist Kredie dhe vijoi në vitin 2005 në pozicionin e Drejtorit të Degës. Nga viti 2006 deri në vitin 2020, Besnik Bani mbajti rolin e Oficerit Rajonal të Kredive pranë “Fondit Besa”. Aktualisht ai mban pozicionin e Përgjegjës të Departamentit të Menaxhimit të Buri-meve Njerëzore pranë “UBA Bank”.



ORGANOGRAMA E SHOQËRISË ASF:



HISTORIKU INSTITUCIONAL

2001 – Krijohet “Building Future” si program mikrofinanciar i World Vision Albania, fillimisht me hapjen e zyrës së parë në rajonin e Lezhës.

2009 – Kalon Institucion Mikrofinanciar me formë ligjore “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” - Vision Fund Albania. Në pronësi dhe kontroll 100% të VisionFund International degë e World Vision International.

Dhjetor 2009 – Agro & Social Fund mori licencën nga Banka e Shqipërisë Nr. 17, si Institucion Financiar i Mikrokredisë.


Nëntor 2016 - VisionFund International vendos tërheqjen e përfaqësisë së tyre nga Shqipëria, kështu që në muajin Dhjetor 2016, u arrit marrëveshja e shitjes së Institucionit tek Fondi Besa sh.a, institucioni financiar jobankar më i madh në Shqipëri.

Dhjetor 2016 e deri tani - Fondi Besa është pronari dhe Aksionari i Vetëm i këtij institucioni me zotërimin e 100% të aksioneve.

Korrik 2025 – Institucioni realizoi shndërrimin e formës ligjore në “Shoqëri Aksionare”, me emërtimin Agro Social Fund SHA (ASF). Fondi Besa mbetet pronari dhe Aksionari i Vetëm, me 100% të aksioneve.

RRJETI I DEGËVE TË AGRO SOCIAL FUND

- Dega Rajonale Lezhë – që prej vitit 2001
- Dega Rajonale Korçë – që prej vitit 2003
- Nën Dega Laç – që prej vitit 2007
- Nën Dega Librazhd – që prej vitit 2008
- Dega Rajonale Elbasan – që prej vitit 2011
- Dega Rajonale Tiranë - që prej vitit 2018
- Nën Dega Tiranë – që prej vitit 2020
- Nën Dega Pogradec – që prej vitit 2018
- Nën Dega Bilisht – që prej vitit 2018
- Nën Dega Shkodër – që prej vitit 2024
- Dega Rajonale Lushnje – që prej vitit 2020
- Dega Rajonale Durrës – që prej vitit 2021
- Dega Rajonale Fier- që prej vitit 2023
- Dega Rajonale Shkodër- në vitin 2025 realizohet transformimi i nën degës Shkodër në degë Rajonale



MISIONI & VLERAT THELBËSORE

Misioni i Agro Social Fund

“Agro Social Fund” SHA mbështet zhvillimin e qëndrueshëm, përfshirjen financiare dhe kohezionin social, nëpërmjet asistencës së përgjegjshme financiare, kryesisht të ndërmarrjeve mikro e të vogla dhe individëve, me qëllim lehtësimin e përmirësimit të jetesës, zgjerimin e oportuniteteve për sipërmarrje e punësim në komunitete si gra, të rinj, apo grupe të ndryshme vulnerabël, me fokus zonat rurale e semi- urbane.

Vlerat e Agro Social Fund

“Agro Social Fund” SHA është i fokusuar në përmirësimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve që i ofrohen klientelës së synuar, kryesisht nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm të kërkesave të tyre, krijimit të mundësive për klientët, familjet dhe komunitetet në rritjen e mirqënies, uljen e varfërisë apo vulnerabilitetit, rritjes së aksesit në financë, krijimit të vendeve të reja të punës apo dhe shtimit të vlerës së atyre ekzistuese.

Në rrugëtimin tonë të udhëhequr nga misioni, ne ruajmë e pasurojmë vlerat tona.

Ne përpiqemi t'i shfrytëzojmë këto vlera me qëllimin që të sigurojmë punonjës të motivuar dhe të orientuar drejt rritjes së rezultateve dhe mbrojtjen nga devijimi i misionit, punonjës që do arrijnë të zhvillohen e veprojnë në sintoni të plotë me linjën për rritjen e objektivave të institucionit.

VLERAT TONA

- ☒ Ne jemi të përkushtuar për të punuar pranë njerëzve, me qëllim nxitjen e përmirësimit të jetës së tyre
- ☒ Ne jemi besnikë ndaj qëllimit dhe të përgjegjshëm për burimet që na janë besuar, duke i menaxhuar ato në mënyrë të tillë që të sjellin kthimin maksimal për kompaninë dhe klientët tanë
- ☒ Ne vlerësojmë njerëzit, i konsiderojmë të barabartë dhe u japim atyre përparësi atyre përkundrejt fitimit e qëllimve tradicionale të biznesit, strukturave e sistemeve
- ☒ Ne jemi punonjës dhe një kompani e besuar në treg – ajo e cila qëndron për integritetin dhe vendos një standard për të, duke frymëzuar të tjerët të jenë gjithmonë të besueshëm dhe të ndershëm
- ☒ Ne vlerësojmë e promovojmë transparencën dhe sjelljen etike

SFIDAT & ARRITJET 2025

Viti 2025 ka qenë një vit me rëndësi të veçantë për shoqërinë tashmë ASF sha, i karakterizuar nga transformim institucional, përforsim i qeverisjes dhe vendime strategjike që kanë hedhur themele më të forta për zhvillimin afatgjatë.

Në një mjedis sfidues, por plot mundësi, me sfida përgjithsisht të reja e sflitëse, shoqëria ka demonstruar aftësi përshtatjeje, disiplinë dhe vizion të qartë për të ardhmen. Një nga arritjet më domethënëse ka qenë transformimi i formës ligjore nga SHPK në SHA, në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë. Ky hap përfaqëson një moment kyç në pjekurinë institucionale të shoqërisë dhe reflekton ambicien për rritje të qëndrueshme dhe qeverisje më të avancuar. Paralelisht, forcimi i Këshillit Mbikëqyrës, si në numër ashtu edhe në ekspertizë profesionale, ka rritur cilësinë e vendimmarrjes dhe ka konsoliduar besimin e partnerëve dhe palëve të interesit. Përgjatë kësaj periudhe, shoqëria ka nisur dhe avancuar procesin e ribrandimit, si shprehje e evolucionit të identitetit institucional dhe e vizionit afatgjatë. Ky proces synon të komunikojë më qartë vlerat, ambiciet dhe standardet më të larta të profesionalizmit dhe qeverisjes që shoqëria ka vendosur si objektiv. Në funksion të rritjes së efikasitetit dhe sigurisë, janë realizuar investime të rëndësishme në modernizimin e sistemeve të menaxhimit të të dhënave dhe në infrastrukturën teknologjike. Paralelisht, ka nisur procesi i certifikimit sipas standardeve ISO për sigurinë e informacionit, duke forcuar angazhimin për mbrojtjen e të dhënave dhe transparencën. O Forcimi i përputhshmërisë rregullatore është reflektuar në përmbylljen me sukses të auditimit të dytë nga ASKS, me një nivel të lartë realizimi të rekomandimeve, duke konfirmuar përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të brendshme.

Zgjerimi territorial ka vijuar si pjesë e strategjisë së rritjes, përmes vendosjes në funksionim të plotë të degës së Shkodrës, e cila tashmë operon në mënyrë të pavarur dhe kontribuon në rritjen e aksesit të klientëve në shërbime financiare cilësore. Në tërësi ky vit ka shënuar një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit institucional. Me një vizion të qartë, struktura më të forta dhe një ekip të përkushtuar, shoqëria hyn në fazën e ardhshme të zhvillimit me besim, energji dhe përgjegjësi të shtuar për të ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme dhe me vlerë afatgjatë.

“Member Engagement Award” për Borrow Wisely
Edhe gjatë vitit 2025 #Borrow Wisely, vazhdoi traditën e realizimit të fushatës së sensibilizimit për një huamarrje të zgjuar. Përgjatë kësaj fushate, “Agro Social Fund” ndoqi të njëtin format të edukimit dhe ndërgjegjësimit të stafit, klientëve dhe publikut të gjerë, formën online takimet e kontaktet e drejpërdrejta në aktivitete të ndryshme. Si rrjedhojë e bashkëpunimit afatgjatë dhe të sukseshëm, Institucionit “Agro Social Fund, në Konferencën Vjetore të MFC, të zhvilluar në Tbilisi, Gjeorgji, ASF-së ju akordua cmimi për kontributin saj në fushatën Borrow Wisely.



QËLLIME STRATEGJIKE PËR VITIN 2026


- **ASF** deri në fund të vitit 2026 synon të ketë arritur në një portofol kredie me vlerë absolute prej 1.59 mld lekë (~16.2 mln Euro , por i ndryshueshëm nga kursi në kohë reale) dhe një klientelë aktive rreth 4140 klientë;
- **ASF** deri në fund të vitit 2026 synon të ketë disbursuar kredi për rreth 2860 klientë, me një shumë të disbursuar prej 1.076 mld lekë (rreth 11 mln Euro).
- **ASF** do përdorë të gjithë burimet e veta, në formën më të mirë, për të mbajtur portofolet në risk në nivelin e parashikuar ku $PAR > 30$ rreth 7% dhe PAR deri 30 rreth 12%;
- **ASF** do të forcojë menaxhimin e riskut duke integruar riskun në vendimarrjen strategjike dhe operative, përmirësuar monitorimin e risqeve kyçe dhe përdorimin e analizave të portofolit (Vintage, early earning indicators), duke rritur kapacitetet profesionale dhe eficiencën në vlerësimin e skenarëve dhe prognozave financiare.
- **ASF** do synojë të sigurojë stabilitetin financiar të institucionit nëpërmjet menaxhimit efektiv të likuiditetit, përputhshmerisë me kuadrin ligjor, raportimit financiar të besueshëm dhe menaxhimit proaktiv të rreziqeve financiare.
- **ASF** do synojë konsolidimin e logos dhe identitetit të ri vizual, duke përfshirë të gjithë komponentët e saj, si dhe finalizimin e të gjitha përditësimeve të nevojshme në materialet promovuese dhe informative të institucionit;
- **ASF** synon të forcojë performancën organizative përmes zhvillimit të vazhdueshëm të kapitalit njerëzor, rritjes së motivimit dhe konsolidimit të një kulture pune tashmë të ndërtuar, të bazuar në përgjegjshmëri, bashkëpunim dhe rezultate;
- Arritja e Çertifikimit ISO 27001 përbën një nga qëllimet strategjike kryesore për vitin 2026, me synim forcimin e sigurisë së informacionit, rritjen e besimit dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të menaxhimit të sigurisë së informacionit.
- Përgjatë vitit 2026 **ASF** synon të realizojë Private Credit Rating dhe ESG Assessment në bashkëpunim me MFR, me qëllim rritjen e transparencës institucionale, lehtësimin e investimeve me ndikim të lartë dhe proceseve të benchmarking-ut, si dhe promovimin e praktikave të përgjegjshme në përputhje me standardet ndërkombëtare.

ARRITJET NË KREDIDHËNIE

Viti 2025 prezantoi një paketë të qartë të strategjive dhe objektivave duke u fokusuar në priorizimin e elementëve më të rëndësishëm që kanë ndikim të drejtpërdrejt në rritjen dhe konsolidimin e institucionit. Kreditimi si aktiviteti i vetëm për rritjen e të ardhurave të institucionit udhëheq ambicjen tonë strategjike për të mbështetur bizneset e vogla e të mesme në investimet e tyre e duke rritur kështu numrin e klientëve që çojnë në zgjerimin dhe shtrirjen e institucionit tonë në treg. Pa dyshim që kjo kategori klientele është jo vetëm motori i ekonomisë së vendit, por edhe objektivi ynë për të qëndruar në nivele mikro. Nëpërmjet kësaj qasjeje puna jonë ka konsistuar në diversifikimin e portofolit të kredisë, por pa lënë mënjanë sigurimin e një aktiviteti më të qëndrueshëm në vitet që pasojnë.

Duke qëndruar në të njëjtën linjë, por tashmë me shifrat e mbylljes së vitit rezultuan sa më poshtë:

- Rritja e numrit të kredive aktive rezulton me 3687 kredi, me një rritje prej 1.4% për vitin 2025.
- Rritja e portofolit bruto të kredive aktive rezulton në vlerën 1.398 mld lekë me një rritje prej 6.6% ose 87 mln lekë për vitin 2025.
- Rënie e numrit të kredive të disbursuara. Për vitin 2025 u disbursuan 2,386 kredi ose 8.7% më pak se në vitin e kaluar.
- Rënie e volumit të disbursuar. Për vitin 2025 ka qenë 950,313,000 lekë ose 3% më pak krahasuar me vitin e kaluar.



nr Kredi të
disbursuara
2386



Volumi Kredi të
disbursuara
950 mln lekë



Portofol Aktiv
1.398 mld lekë



Kredi rurale
1,189



Klientë të rinj
43%



Kliente femra
40%



TË DHËNAT VJETORE

(mIn lekë)



Kredi të Disbursuara
në Nr.



Kredi të Disbursuara
në Vlerë



Kredi Aktive



Portofol Outstanding
(mIn lekë)

> 2020	1,813	564	2,788	768
> 2021	2,133	695	3,128	877
> 2022	2,256	805	3,305	1,037
> 2023	2,551	917	3,511	1,174
> 2024	2,613	979	3,636	1,310
> 2025	2,386	950	3,687	1,398



DISBURSIME
KUMULATIVE
(mIn lekë)

2020

4.8 MLD

2021

5.5 MLD

2022

6.4 MLD

2023

7.2 MLD

2024

8.2 MLD


2025

9.2 MLD

Rritja e numrit të kredive aktive per periudhën 5 vjeçare rezulton me 3% rritje në numër dhe 67.3% në vlerë.

Ecuria e treguesve ndër vite

(mln lekë)



Kredi të Disbursuara në Nr.

2,133 → 2,256 → 2,551 → 2,613 → 2,386

(2021 – 2025)



Kredi të Disbursuara në Vlerë

695 → 805 → 917 → 979 → 950

(2021 – 2025)



Kredi Aktive

3,128 → 3,305 → 3,511 → 3,636 → 3,687

(2021 – 2025)



Portofol Outstanding

877 → 1,037 → 1,174 → 1,310 → 1,398


(2021 – 2025)

Fokusi ynë janë klientët.

Agro Social Fund SHA vijon të qëndrojë në treg me një aktivitet tashmë më të zgjeruar dhe me një rritje të qëndrueshme duke ofruar procedura më të lehtësuara për t'iu përshtatur nevojave të tregut. Fokusi ynë janë klientët. Për të mbajtur një klientelë të fortë si dhe për të thithur të rinj, ASF i jep një rëndësi të vecantë proceseve të kredidhënies duke përshtatur procedurat dhe standartet si dhe duke nxjerr produkte të reja sipas nevojave dhe kërkesave të tregut ku operon.

PRODUKTET E KREDISË

	START-UP	 SHUMA DERI NË 400,000 LEKË	 AFATI DERI NË 36 MUAJ	 INTERESI PËRCAKTOHET NGA SHUMA E KREDISË
	KREDIA JESHILE	 SHUMA DERI NË 1,000,000 LEKË	 AFATI DERI NË 48 MUAJ	 INTERESI PËRCAKTOHET NGA SHUMA E KREDISË
	KREDIA KONSUMATORE	 SHUMA DERI NË 1,000,000 LEKË	 AFATI DERI NË 48 MUAJ	 INTERESI PËRCAKTOHET NGA SHUMA E KREDISË
	KREDIA SOCIALE	 SHUMA DERI NË 400,000 LEKË	 AFATI DERI NË 36 MUAJ	 INTERESI PËRCAKTOHET NGA SHUMA E KREDISË
	GRUAJA RURALE	 SHUMA DERI NË 600,000 LEKË	 AFATI DERI NË 48 MUAJ	 INTERESI PËRCAKTOHET NGA SHUMA E KREDISË
	TË RINJTË SIPËRMARRËS	 SHUMA DERI NË 500,000 LEKË	 AFATI DERI NË 36 MUAJ	 INTERESI PËRCAKTOHET NGA SHUMA E KREDISË
	KREDI BIZNESI	 SHUMA DERI NË 2,000,000 LEKË	 AFATI DERI NË 72 MUAJ	 INTERESI PËRCAKTOHET NGA SHUMA E KREDISË
	KREDI AGRO	 SHUMA DERI NË 2,000,000 LEKË	 AFATI DERI NË 84 MUAJ	 INTERESI PËRCAKTOHET NGA SHUMA E KREDISË
	PRODUKT FAST	 SHUMA DERI NË 600,000 LEKË	 AFATI DERI NË 18 MUAJ	 LËVRIMI BREND 3 ORËVE, PA GARANTOR
	PRODUKT EIF	 SHUMA DERI NË 2,500,000 LEKË	 AFATI DERI NË 84 MUAJ	 INTERESI PËRCAKTOHET NGA SHUMA E KREDISË



SEKTORËT E INDUSTRIË



SHPËRNDARJA E PORTOFOLIT SIPAS PRODUKTEVE



Biznes

45%



Kredi Jeshile

3%



Agro

22%



Sociale

2%



Projektet

12%



Start-up

2%



EIF

7%



Gruaja Rurale

2%




Konsumatore

6%



Të rinjtë sipërmarrës

1%



PORTOFOLI SIPAS SEKTORËVE



Shërbime

33%



Bujqësi&Blegtori

35%



Tregti

4%




Individuale

25%



Prodhim

3%



MENAXHIMI I PORTOFOLIT NË RISK

Institucioni vijon të operojë mbi një kulturë të konsoliduar të menaxhimit të riskut, e cila buron nga vlerat dhe standartet e përbashkëta organizative dhe reflektohet në mënyrën se si realizohet aktiviteti i përditshëm i kredidhënies. Kjo kulturë mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të portofolit dhe siguron një balancë të kujdesshme ndërmjet rritjes së biznesit dhe kontrollit të ekspozimeve ndaj riskut, duke ruajtur në fokus transparencën dhe përgjegjshmërinë ndaj klientëve gjatë gjithë ciklit të marrëdhënies kreditore.

Departamenti i Menaxhimit të Riskut ka vijuar të luajë një rol të rëndësishëm në garantimin e zbatimit të kuadrit të brendshëm rregullator, përmes proceseve të strukturuar që përfshijnë identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe raportimin e risqeve. Në këtë kuadër, infrastruktura ekzistuese është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme, duke forcuar kapacitetet e monitorimit dhe duke rritur efikasitetin e kontrolleve të brendshme.

Kjo qasje ka kontribuar në:

- forcimin e disiplinës së brendshme në menaxhimin e riskut;
- përmirësimin e cilësisë së analizës dhe vlerësimit të ekspozimeve ndaj riskut;
- rritjen e efektivitetit të procesit vendimmarrës të bazuar në risk dhe të dhëna;
- konsolidimin e një strukture të integruar menaxhimi që mbulon të gjithë ciklin e riskut, përfshirë identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e vazhdueshëm të tij.

Në këtë mënyrë, menaxhimi i riskut mbetet një komponent i integruar në proceset strategjike dhe operacionale të institucionit, duke mbështetur qëndrueshmërinë afatgjatë dhe mbrojtjen e portofolit.

Si pjesë të aktivitetit normal të biznesit, Departamenti i Menaxhimit të Riskut ka patur nën ndjekje gjatë vitit 2025 llojet e risqeve, të ndara sipas kategorive/nënkategorive të mëposhtme:

KATEGORIA	NËN-KATEGORIA
Strategjik	Risku i Qeverisjes
	Risku Reputacional
	Risku Ligjor dhe i Përputhshmërisë (Ligjore)
Financiare	Risku i Kredise
	Risku i Dimensionit Social të Misionit
	Risku i Tregut
	Risku i Likuiditetit
	Risku i Normës së Interesit
	Risku i Kursit të Këmbimit
Operacionale	Risku i Kapitalit Njerëzor


Gjatë vitit 2025, ekonomia shqiptare ka vijuar të shfaqë një ecuri pozitive, e mbështetur nga zgjerimi i aktivitetit ekonomik dhe konsolidimi i stabilitetit makroekonomik. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) ka vijuar të regjistrojë rritje të qëndrueshme, ndërsa inflacioni është mbajtur në nivele të ulëta dhe pranë objektivit, duke reflektuar një balancë më të mirë ndërmjet kërkesës dhe ofertës në ekonomi. Indeksi i çmimeve të konsumit ka shënuar rritje të moderuar, kryesisht të ndikuar nga grupi i ushqimeve dhe shërbimeve, ndërkohë që çmimet e energjisë kanë qenë relativisht të stabilizuara krahasuar me periudhat e mëparshme. Rritja ekonomike është mbështetur kryesisht nga sektorët e tregtisë, ndërtimit dhe pasurive të paluajtshme, të cilët vijojnë të kenë një kontribut të rëndësishëm në strukturën e rritjes ekonomike të vendit.

Tregu i punës ka ruajtur një stabilitet të përgjithshëm, me nivele të kontrolluara të papunësisë, ndërsa zhvillimet sektoriale kanë qenë të diferencuara, ku industria dhe ndërtimi kanë shfaqur përmirësime, ndërkohë që disa segmente të shërbimeve dhe bujqësisë kanë vijuar me ritme më të moderuara rritjeje. Në tërësi, mjedisi makroekonomik paraqitet i qëndrueshëm dhe i konsoliduar, duke krijuar kushte relativisht të favorshme për zhvillimin e aktivitetit financiar dhe kreditues, si dhe për ruajtjen e stabilitetit në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Në këtë kontekst, për një institucion mikrokredie si ASF, operimi në një mjedis konkurrues dhe të ndjeshëm ndaj ndryshimeve ekonomike kërkon një qasje të disiplinuar dhe të strukturuar ndaj menaxhimit të riskut.

Sigurimi i cilësisë së portofolit të kredisë, menaxhimi i likuiditetit, respektimi i treguesve kapitalë dhe ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit dhe kursit të këmbimit përbëjnë elementë thelbësorë të kuadrit të përgjithshëm të riskut, në përputhje me kërkesat rregullatore dhe politikat e brendshme të institucionit.


Menaxhimi i riskut zbatohet përmes një qasjeje sistematike dhe të vazhdueshme, të mbështetur në analiza periodike, raporte monitorimi dhe mekanizma kontrolli, me qëllim identifikimin, matjen dhe vlerësimin e ekspozimeve të mundshme. Në këtë kuadër, vëmendje e veçantë i kushtohet rrezikut të kreditit, rrezikut të likuiditetit, rrezikut të tregut dhe rrezikut operacional. Strategjitë e aplikuara përfshijnë diversifikimin e portofolit, menaxhimin e maturiteteve dhe monitorimin e vazhdueshëm të ekspozimeve, me synim ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare dhe minimizimin e ndikimit të faktorëve të jashtëm mbi aktivitetin e institucionit.

CILËSIA E PORTOFOLIT TË KREDISË




Rritja e portofolit të kredisë ishte në nivele të kënaqshme gjatë vitit 2025, ndërkohë që niveli i PAR-it mbi 30 ditë, u mbyll me 7.96%.

Provigjionimi, duke patur ndikim kyç në rezultatin financiar të ASF-së, është nën përgjegjësinë e Departamentit të Menaxhimit të Riskut, duke ndjekur rigorozisht rregullat e Bankës së Shqipërisë dhe të standarteve IFRS9, nëpërmjet materializimit me procedura dhe politika rregullatore.



Klasifikimi i Portofolit të Kredisë

Dhjetor 2025



Lidhur me përbërjen e portofolit të kredive aktive, 92.03% klasifikohen si “Kredi Standarte”, ç’ka dëshmon një cilësi stabël të portofolit. Fokusi në vijim, do të jetë përmirësimi në peshë të klasave mbi 30 ditë.

Në fokus të Departamentit të Menaxhimit të Riskut, edhe gjatë këtij viti ushtrimor, ka vijuar forcimi i masave dhe vigjilencës ndaj parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në këtë kuadër, është siguruar pjesëmarrja në workshop-e dhe aktivitete trajnuese të organizuara nga institucione dhe entitete relevante të fushës, si dhe janë zhvilluar trajnime periodike të stafit tone, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së plotë me kërkesat rregullatore në fuqi.

MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Departamenti i Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2025 ka vijuar të mbështesë zhvillimin e institucionit përmes menaxhimit efektiv të stafit dhe forcimit të kapaciteteve profesionale. Fokus i veçantë i është kushtuar krijimit të një mjedisi pune motivues dhe profesional, ku vlerësohet kontributi i çdo punonjësi dhe inkurajohet bashkëpunimi ndërmjet ekipeve.

Në funksion të objektivave strategjike të institucionit, janë ndërmarrë iniciativa për përmirësimin e proceseve të rekrutimit, zhvillimit profesional dhe menaxhimit të performancës, duke synuar rritjen e efikasitetit dhe angazhimit të stafit. Gjithashtu, vëmendje e veçantë i është kushtuar zhvillimit të kulturës organizative dhe ruajtjes së standardeve të larta etike dhe profesionale.

Përkushtimi ndaj zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore ka ndikuar në forcimin e stabilitetit institucional dhe në krijimin e një ambienti pune pozitiv, që mbështet rritjen dhe zhvillimin afatgjatë të ASF-së.

Numri i punonjësve në fund të vitit 2025: 96 punonjës.



40% - meshkuj



60% - femra

ASF zhvilloi më 13 shkurt 2026 Analizën Vjetore për vitin 2025, e cila shërbeu si një platformë e rëndësishme për vlerësimin e rezultateve të arritura dhe sfidave të hasura gjatë vitit. Kjo analizë përfaqëson një tryezë pune ku strukturat dhe nivelet e menaxhimit prezantojnë arritjet, projektet dhe sfidat, si dhe identifikojnë nevojat dhe objektivat për të ardhmen. Procesi bazohet në një qasje gjithëpërfshirëse dhe në debat profesional, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës dhe rritjen e efektivitetit të institucionit.



Gjatë vitit 2025, zhvillimi profesional i stafit ka qenë në fokus të Departamentit të Burimeve Njerëzore, me qëllim rritjen e kapaciteteve teknike dhe forcimin e kompetencave menaxheriale, kryesisht për stafin e zyrës qendrore (HO). Në total, stafi drejtues dhe specialistë të ASF-së, gjatë 2025-ës morën pjesë në 20 programe trajnimi, certifikime profesionale dhe webinarë me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale, forcimin e kulturës së riskut, sigurisë dhe përputhshmërisë ligjore, sigurinë kibernetike, mbrojtjen e të dhënave personale, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe transformimin dixhital. Paralelisht, gjatë vitit u realizuan edhe trajnime orientimi nga departamentet e ASF-së për stafin e ri të punësuar, me qëllim integrimin e tyre në strukturat dhe proceset e punës së institucionit.

Marketingu

Agro Social Fund SHA ka operuar për afro një dekadë nën emrin dhe logon Agro & Social Fund sh.p.k., periudhë gjatë së cilës ka shënuar zhvillime të rëndësishme, si rritja e ndjeshme e portofolit të kredisë, zgjerimi i produkteve dhe shtrirja gjeografike në zona rurale dhe urbane. Këto zhvillime, së bashku me procesin e transformimit të formës ligjore, krijuan nevojën për rishikimin e identitetit vizual dhe pozicionimit në treg.

Në këtë kuadër, institucionin ndërmori procesin e ribrandimit, duke u identifikuar me emrin tregtar ASF dhe një identitet të ri vizual, më bashkëkohor dhe përfaqësues. Ribrandimi u shtri pothuajse në të gjitha degët, duke përfshirë përmirësimin e elementeve fizike dhe promovuese, si dhe brandimin e automjeteve, me qëllim forcimin e prezencës dhe unifikimin e imazhit institucional.

Paralelisht, gjatë periudhës shtator–nëntor 2025, u realizua menaxhimi i rrjeteve sociale përmes shërbimit outsourcing, i shoqëruar me një fushatë marketingu të dedikuar, e cila kontribuoi në rritjen e dukshmërisë dixhitale dhe në forcimin e perceptimit të ASF-së si një institucion modern, profesional dhe i besueshëm.

Gjatë muajit Tetor 2025, ASF zhvilloi fushatën sensibilizuese për një huamarrje të zgjuar #Borrow Wisely. Kjo fushatë nisi paraprakisht me trajnimin e stafit të degëve, për të mundësuar aftësimin e tyre për shpërndarjen e mesazheve, koncepteve dhe detajeve shpjeguese. Në të njëjtën kohë në rrjetet sociale të ASF-së u publikuan me postime të njëpasnjëshme të gjitha elementet e një huamarrje të zgjuar, të cilat i ndihmojnë individët të kuptojnë hap pas hapi se çfarë të kërkojnë në mënyrë që të jenë të mirëinformuar para se të marrin një kredi.

Në muajin Nëntor 2025, ASF iu bashkua fushatës “Mikrofinanca për Sipërmarresit në Moshën 50-64 vjeç”, një nismë që synon të forcojë rolin e mikrofinancës në mbështetjen e sipërmarrësve në moshë të rritur dhe të nxisë një ekosistem më gjithëpërfshirës për bizneset e vogla. Sipas raportit të OECD “The Missing Entrepreneurs”, mbi 5 milionë persona të moshës 50–64 vjeç në BE mungojnë në sipërmarrje – një potencial i madh i pashfrytëzuar për zhvillimin ekonomik.



AKTIVITETE

Pjesëmarrja në aktivitete të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit ka qenë një tjetër fokus i rëndësishëm institucional, duke shërbyer si një mënyrë efektive për rritjen e vizibilitetit, shkëmbimin e njohurive dhe ndërtimin e bashkëpunimeve dhe partneriteteve që kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të institucionit.

Në datat 27-29 Maj 2025 ASF mori pjesë në edicionin e 27-të i Konferencës Vjetore të MFC, tematika e së cilës ishte “Shifts, Shocks and Solutions: Microfinance in the Shadow of Geopolitics”. Gjatë ditëve në këtë Konferencë, përfaqësuesit e ASF-së zhvilluan takime në mbështetje apo zgjerim të network-ut të partnerëve me Triple Jump, Enabling Capital, , Inpulse, Frankfurt School Financial Services, ResponsAbility dhe MCE Social Capital, Grameen Credit Agricole, Blue Orchard etj, si dhe u ndoqën takime në të cilat u diskutuan tema me rëndësi strategjike për sektorin. Gjithashtu, në këtë konferencë për të tretin vit rradhazi, ASF-së ju akordua cmimi për kontributin saj në fushatën Borroë Wisely 2024!



Gjatë datave 15–17 Tetor 2025, ASF mori pjesë në Konferencën Vjetore të European Microfinance Network (EMN), e zhvilluar në Cagliari, Itali, e cila këtë vit u fokusua në temën “Roadmap to Sustainability and Inclusive Development: Microfinance as a Catalyst for Building Stronger Local Communities”. Ky aktivitet mblodhi institucione mikrofinanciare, organizata zhvillimi dhe partnerë europianë, duke krijuar një platformë të rëndësishme për shkëmbimin e praktikave më të mira, ideve dhe qasjeve inovative mbi rolin e mikrofinancës në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, përfshirjes financiare dhe inovacionit social. Pjesëmarrja e ASF-së në këtë konferencë theksoi angazhimin e institucionit për këto prioritetë strategjike, ndërsa përfaqësuesit tanë patën mundësinë të ndajnë përvojën e tyre në fushën e mikrofinancës, të diskutojnë sfidat aktuale të sektorit dhe të forcojnë bashkëpunim in me institucione evropiane.

IT

IT që fuqizon rritjen dhe sigurinë

Në vitin 2025, Departamenti i IT u pozicionua si një shtyllë kyçe në transformimin dhe qëndrueshmërinë e institucionit. Me fokus në sigurinë, inovacionin dhe përvojën e përdoruesit, u avancua ngritja dhe plotësimi i dokumentacionit sipas standardit ndërkombëtar ISO/IEC 27001:2022, duke vendosur baza të forta për implementimin e plotë dhe procesin e certifikimit në vijim, si dhe duke forcuar përputhshmërinë rregullatore. Investimet në sigurinë kibernetike dhe monitorimin inteligjent (SIEM) rritën ndjeshëm rezistencën ndaj kërcënimeve, ndërsa transformimi i sistemit kryesor financiar Odoo ProBank hyri në një fazë të avancuar testimi dhe optimizimi, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt një platforme më të shpejtë, më efikase dhe më të orientuar ndaj përdoruesit. Infrastruktura IT u forcua për të siguruar disponueshmëri maksimale dhe performancë të qëndrueshme, duke mbështetur pa ndërprerje operacionet e biznesit. Paralelisht, u promovua inovacioni përmes adoptimit të teknologjive të reja dhe zhvillimit të vazhdueshëm të stafit.

Investim në njerëz dhe ekspertizë Në kuadër të rritjes së kapaciteteve profesionale dhe forcimit të sigurisë institucionale, ekipi IT përfundoi me sukses certifikime kyçe si CompTIA Security+ dhe Data Protection Officer (DPO). Këto arritje përforcojnë ekspertizën në sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve, menaxhimin e rrezikut dhe incidenteve, si dhe sigurojnë përputhshmëri të plotë me kërkesat e GDPR, duke garantuar mbrojtjen e të dhënave të klientëve dhe stafit. Me një qasje të orientuar drejt së ardhmes, IT kontribuoi edhe në iniciativa të qëndrueshmërisë dhe efikasitetit energjetik, duke parashikuar e ndërtuar një ekosistem teknologjik të sigurt, inteligjent dhe të qëndrueshëm.



PERFORMANCA SOCIALE

ASF vlerëson, ndjek dhe synon përmiresimin e treguesve të Performancës Sociale duke respektuar përcaktimet ndërkom-bëtare mbi matjen dhe raportimin e tyre. Agro & Social Fund mat dhe raporton treguesit e performances sociale për të gjithë palët e interesuara:

- Klientët, të cilët mund të jenë të shqetësuar për etikën dhe impaktin social të blerjeve e investimeve të tyre, dhe se gjatë periudhës së vështirë që kaluam dhe po kalojmë kërkojnë të ndiejnë prezencën dhe afërsinë tonë në momentet e vështira.
- Ortakët, që kërkojnë të kenë në konsideratë impaktin social dhe rreziqet mjedisore për vendimet e tyre për investime, të cilët në periudha të tilla të vështira do të duan të sigurohen se institucioni nuk po e humb fokusin e tij social.
- Komunitetet në të cilat operon, që kërkojnë të dinë vlerën që ne kontribuojmë në shoqëri, veçanërisht në situata të tilla të jashtëzakonshme, ku fokusi social i institucioneve reflektohet më së shumti.
- Punonjësit, që duan siguri se kompania ku ata punojnë është një kompani që kujdeset për impaktin social dhe mjedisor që ka aktiviteti i saj.

si dhe që tregon kujdes të shtuar për mirëqenien shëndetsore fizike dhe mendore të stafit kur punohet në kushte të veçanta të diktuar nga faktorë të jashtëm.

- Partnerët, të cilët kërkojnë të vihen në djeni për impaktin social të projekteve të implementuara në bashkëpunim me ASF dhe të sigurohen që edhe pse institucioni mund të jetë duke punuar në kushte jo shumë të favorshme të mos shkelë parimet sociale të deklaruara dhe kontraktuara.

ASF vepron në përputhje me Sustainable Development Goals (SDG). Në terma të përgjithshëm, aktiviteti i ASF ka një ndikim, në shkallë të ndryshme, në trembëdhjetë SDG.

#1: No Poverty

#2: Zero Hunger

#3: Good Health and Well-Being

#4: Quality Education

#5: Gender Equality

#7: Affordable and Clean Energy

#8: Decent Work and Economic Growth

#9: Industry, Innovation, and Infrastructure

#10: Reduced Inequalities

#11: Sustainable Cities and Communities

#14: Life Below Water

#15: Life on Land

#17: Partnerships for the Goals



RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Ortakun dhe Personat e Ngarkuar me Qeverisjen e Shoqërisë Agro Social Fund Sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Agro Social Fund Sh.a. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2025, si dhe pasqyrën e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe të fuksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2025, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standard Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazë për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standard Ndërkombëtar të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabiliteteve Profesionale (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavaresisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shoqëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

- Vlerësojmë prezantinë e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantinë të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përkatëse në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Shoqërisë për vitin 2025 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përmiryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Nëse arrijmë në përfundimin se ka një gabim material në të, ne jemi të detyruar t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen.

Buyar Bendo
Auditues Ligjor
RSM Albania
Tiranë, 17 Prill 2026



Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përkatjen dhe paraqjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përkatjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomal materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit.

Në përkatjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç, sa më shpejt.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektiviteti tona janë të marim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomal materiale, për shkak të mashtimit, apo gabimit, dhe të leshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomal materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticitëzin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marim evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqesime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet, ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

Impakti Social

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, ASF ka:

Shërbyer 2,400 klientëve

Ruajtur 7,070 & Krijuar 143 vende pune

Përmirësuar jetën e 6,768 fëmijëve

Financuar 89 sipërmarrje të reja

Shërbyer 54% klientëve rurale dhe 41% klienteve femra

Shërbyer 574 klientëve të rinj (grupmosha 18-35 vjeç)

Projekte dhe Partnerë



Kiva - Gjatë vitit 2025 në kiva janë financuar \$ 281,480.00, duke i ardhur kështu në ndihmë investimeve në Bujqësi, Edukim, Shëndetësi, Grave në zonat rurale, Bizneseve të Reja, Të Rinjve Sipërmarrës dhe Komuniteteve Vulnerabël



“Dorcas Aid International” Albania - Projekti “PËR NXITJEN E SIPËRMARRJES NË RAJONIN E TROPOJËS dhe PUKËS NËPËRMJET KREDITIMIT” u nënshkrua rishtazi me qëllim vënien në dispozicion të një fondi të ri, i cili do të përdoret me qëllim vazhdimin e suportimit të familjeve në

(Shumat në mijë Lek)

(Shumat në mijë Lek)	2025	2024
Aktivët		
Mjete monetare dhe ekuivalentët me to	521,628	346,227
Hua dhe paradhënie për klientët	1,285,481	1,217,601
Aktivët afatgjatja materiale	11,011	11,652
Të drejtat e përdorimit të aktiveve	86,426	49,044
Aktive të tjera	16,843	13,551
Totali i aktiveve	1,921,389	1,638,075
Detyrimet dhe Kapitali i vet		
Detyrimet		
Huate	1,358,855	1,131,153
Detyrimet mbi Qeratë	89,125	49,065
Detyrime të tjera	17,195	27,435
	1,465,175	1,207,653
Kapitali i vet		
Kapitali aksionar	400,000	289,375
Rezerva ligjore	1,290	-
Humbje të mbartura	29,132	110,166
Fitimi i vitit	25,792	30,881
	456,214	430,422
Totali i detyrimeve dhe Kapitali i vet	1,921,389	1,638,075



(Shumat në mijë Lek)

(Shumat në mijë Lek)	2025	2024
Interesa		
Të ardhura nga interesi	353,817	330,034
Shpenzime për interesa	-84,275	-64,275
Të ardhura neto nga interest	269,542	265,759
Të ardhura/(Shpenzime) të tjera	7,733	2,715
Shpenzime operative		
Amortizim i aktiveve	-20,739	-20,376
Shpenzime personeli	-151,174	-139,305
Humbje nga zhvlerësimi i huave	-31,636	-23,042
Shpenzime të tjera	-45,819	-45,288
Fitim/(humbje) neto nga kurset e këmbimit	5,219	237
Totali i shpenzimeve operative	-244,149	-227,774
Fitim/(humbja) përpara tatimit	33,126	40,700
Tatim fitimi	-7,334	-9,819
Fitim/(humbja) për vitin	25,792	30,881
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, pas tatimit	-	-
Totali i të ardhurave/(humbjes) gjithëpërfshirëse për vitin	25,792	30,881

Pasqyra e flukseve të monetare
(Shumat në mijë Lek)

Pasqyra e flukseve të monetares (Shumat në mijë Lek)	2025	2024
Flukset monetare nga aktivitetet operacionale		
Fitimi i vitit përpara tatimit	33,126	40,700
Korrigjime për:		
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	3,418	2,800
Amortizimi i të drejtave të përdorimit të aktiveve	17,310	17,682
Humbje nga zhvlerësimi i huave	31,636	23,042
Humbje nga shitja e aktiveve fikse	73	
Të ardhura nga interesi	-353,817	-330,034
Shpenzime për interesa	84,275	64,275
Ndryshime në:		
Hua dhe paradhënie për klientët	-98,822	-143,254
Aktive të tjera	-3,292	-6,812
Detyrime të tjera	-4,423	-2,430
	-290,517	-334,031
Interesi i arkëtuar	352,794	330,010
Interesi i paguar	-80,523	-58,403
Tatimi mbi të ardhurat i paguar	-10,485	-6,270
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet operacionale	-28,730	-68,695
Flukset monetare nga aktivitetet investuese		
Shitje e aktiveve afatgjata materiale	80	
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	-3,062	-2,943
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet investuese	-2,982	-2,943
Flukset monetare nga aktivitetet financiare		
Fonde të marra si hua	1,047,570	1,443,617
Fonde të paguara si hua	-820,923	-1,082,117
Ripagesa për detyrimet mbi qiratë	-19,534	-18,991
Flukset monetare nga aktivitetet financuese	207,113	342,509
(Rënia)/ritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to	175,402	270,871
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fillim të vitit	346,226	75,356
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në fund të vitit	521,628	346,227

BASHKËPUNËTORËT TANË





RRJETET TONA SOCIALE



www.asf.al



[asf_sha_](https://www.instagram.com/asf_sha_)



ASF- Agro Social Fund



ASF SHA